British Embassy Skopje

Qendra për Administrim me Ndryshime

Instituti për të Drejtat e Njeriut

MANUALI i GAZETARISË INVESTIGATIVE

DHE QASJA NË INFORMACIONE

MANUALI

I GAZETARISË INVESTIGATIVE DHE QASJA NË INFORMACIONE

MANUALI I GAZETARISË INVESTIGATIVE DHE QASJA NË INFORMACIONE

Botues:

Shoqata e qytetarëve Instituti për të Drejtat e Njeriut

Shoqata për Zhvillim Qendra për Administrim me Ndryshime

Për botuesin:

Margarita Caca Nikollovska

Neda Malleska Saçmaroska

Autorë:

Sase Dimovski

Nenad Mircevski

Redaktorë:

Mirosllav Draganov

Maja Stojanoska

Përktheu:

Blerina Starova Zllatku

Lektura:

Tatjana Stojanovska

Disenji dhe shtypi

Brigada disenj sh.p.k.

Tirazhi

400 ekzemplarë (Tirazh falas/jokomercial)

Në formë elektronike publikimi është i aksesshëm në www.ihr.org.mk dhe në www.cup.org.mk

CIP – Katalogizimi në publikim
Biblioteka Nacionale dhe Universitare "Shën Klimenti i Ohrit", Shkup
070-047.37(035)

DIMOVSKI, Saše
Manuali i gazetarisë investigative dhe qasja në informacione /
[Saše Dimovski, Nenad Mirčevski]. - Skopje : Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2016. - 18 f. ; 21 см

Fusnota të tekstit

ISBN 978-608-66024-1-3
1. Mirčevski, Nenad [autor]
a) Gazetarisë investigative - Qasja në informacione - Manualë
COBISS.MK-ID 102015498

Ky publikum është prodhuar në kuadër të projektit "Gazetaria investigative-gardian I demokracisë dhe i të drejtave të njeriut", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ambasada britanike në Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Britanike në Shkup.

British Embassy Skopje

Hyrje

Gazetaria investigative ka një rëndësi kruciale për realizimin e rolit të mediave në demokracitë bashkëkohore si gardiane e publikut dhe mbrojtëse e të drejtave të njeriut. Detyra më e rëndësishme e gazetarëve në shoqëritë demokratike është mbrojtja e interesave të qytetarëve. Që ta realizojnë këtë detyrë, gazetarët zbulojnë abuzime të pushtetit dhe fuqisë së individëve dhe institucioneve dhe në këtë mënyrë kontribuojnë për një qeverisje të përgjegjshme dhe llogaridhënëse, duke e promovuar interesin publik.

Gazetaria investigative mësohet si lëndë në fakultetet e gazetarisë, ndërsa mediat profesionale akordojnë mjete të veçanta për investigime gazetareske dhe i trajnojnë gazetarët e tyre se si të investigojnë.

Gazetaria investigative zbatohet në bazë të rregullave dhe standardeve të vendosura. Për punën e gazetarëve investigues është i rëndësishëm respektimi i normave morale të profesionit të gazetarit, si dhe korniza ligjore për akses deri te informacionet me karakter publik.

Ky Manual për gazetari investigative dhe qasjes në informacione është mekanizëm për përdorim të përditshëm dhe, para së gjithash, u dedikohet studentëve të gazetarisë dhe gazetarëve të rinj të cilët kanë dëshirë dhe mundësi të merren me gazetari investigative .

KAPITULLI 1:
ÇKA ËSHTË GAZETARIA INVESTIGATIVE?

Raportimi gazetaresk mund të jetë informativ - ditor, analitik dhe investigativ.

1.1. Gazetaria informative - ditore

Detyrat informative - ditore të gazetarëve janë transmetimi i komunikatave dhe deklaratave nga persona publikë dhe institucione, të raportojnë nga ngjarje - pres-konferenca, kongrese, koncerte, ndeshje sportive dhe ngjashëm, si dhe për gjendje dhe dukuri të caktuara në shoqëri. Për informacionet dhe lajmet që i publikojnë, gazetarët kërkojnë reagime dhe opinione nga institucionet kompetente ose nga personat e interesuar dhe i transmetojnë publikisht, meqë gazetaria informative-ditore ndryshe emërtohet edhe si gazetari reaktive.

1.2. Gazetaria analitike

Për gazetarinë analitike karakteristike është ajo që gazetarët shkojnë një hap më tutje kështu që ngjarjet dhe situatat, për të cilat raportojnë, i vendosin në një kontekst të veçantë, i plotësojnë me sfondin shoqëror, i përkujtojnë ngjarjet e ngjashme, dukuritë ose deklaratat të cilat u kanë paraprirë, i interpretojnë dhe analizojnë, i sqarojnë dhe justifikojnë, në mënyrë që lexuesit dhe publiku ta kuptojnë më mirë thelbin e tyre.

1.3. Gazetaria investigative

Gazetaria investigative është forma më e vështirë dhe më serioze e gazetarisë. Ajo kërkon shumë punë, kohë dhe resurse të cilat për fat të keq në kushtet maqedonase, një numër i vogël i redaksive ose një numër i vogël i gazetarëve mund t'ia lejojë vetvetes.

Gazetaria investigative është më e vlerësuara, më emocionuese dhe interesante dhe shpesh shpërblehet nëse punohet sipas rregullave të përcaktuara dhe nëse zbatohen standardet gazetareske.

Në gazetarinë investigative gazetarët kërkojnë prova lidhur me informacionet të cilat i plasojnë institucionet dhe personat publikë, gërmojnë më thellë që të zbulojnë se çka fshihet pas komunikatave, deklaratave, ngjarjeve dhe situatave.

Gazetaria investigative është një proces në të cilin gazetari zbulon informacione, fakte dhe numra të cilat i posedojnë institucionet shtetërore dhe publike, kompanitë, personalitetet dhe nuk duan t'i ndajnë me publikun, ndërkaq janë me interes publik apo me zbulimin e tyre do të prevalojë interesi publik.

Gazetaria investigative më së shpeshti ka të bëjë me hulumtimin e krimit dhe korrupsionit në të gjitha format. Në publik fitohet përshtypje se gazetarët investigues kanë fuqi që përmes hulumtimeve të tyre personat e korruptuar t'i vënë para drejtësisë, që nuk është plotësisht e pasaktë, meqë storjet investigative, në një numër të madh të rasteve në botë, kanë qenë bazë që policia, prokuroria publike apo organet e tjera, të cilat e ndjekin krimin dhe korrupsionin, të ngrenë procedura gjyqësore pikërisht mbi të dhënat e grumbulluara në kuadër të investigimeve gazetareske.

Megjithatë, duhet të bëjmë dallim midis punës së gazetarëve investigues dhe organeve hetuese shtetërore. Zbulimet e organeve shtetërore hetuese mund, për shembull, të jenë vetëm bazë solide për storje investigative, ndërsa zbulimet e gazetarëve mund të shërbejnë për hapjen e hetimit në bazë të zërit të dëgjuar në publik.

1.4. Përkufizime të gazetarisë investigative

Sipas organizatës amerikane **Gazetarë dhe Redaktorë Investigues** (IRE – Investigative Reporters and Editors), gazetaria investigative është **gazetari, e cila zbulon fakte, veçanërisht ato të cilat qëllimisht ruhen si konfidenciale**.

Për Organizatën Holandeze-Flamane të gazetarisë investigative, gazetaria investigative përfshin një kornizë më të gjerë:

- Zbulim të skandaleve dhe shkelje të ligjeve, rregullave dhe standardeve etike nga individë dhe institucione
- Investigim të politikave ose funksioneve të institucioneve në pushtet, biznes kompanive ose organizatave joqeveritare, kishave, etj.
- Përshkrim të tendencave shoqërore, ekonomike, politike dhe kulturore
- Interpretim dhe ndërlidhje të fakteve të njohura në mënyrë të panjohur

1.5. Elementët kyç të gazetarisë investigative

Në praktikë hasim më shumë përkufizime për gazetarinë investigative, megjithatë tiparet kryesore për të cilat të gjithë janë dakord, përkatësisht elementët të cilët duhet t'i përmbajë çdo investigim gazetaresk janë si vijojnë:

- **Puna origjinale investiguese e gazetarit**
- **Zbulimi i informacioneve me interes publik të cilat tentojnë t'i fshehin individë, organizata ose institucione qeveritare**
- **Investigimi i cili e vë në dukje problemin me interes më të gjerë publik**

Veçoria kryesore e çdo investigimi gazetaresk konsiston me atë që të jetë **punim origjinal gazetaresk,** investigim personal të cilin e zbaton gazetari, dhe jo bartje të rezultateve dhe të dhënave të grumbulluara nga dikush tjetër. Së këtejmi, duhet të bëhet dallimi midis investigimit (temë në të cilën janë përfshirë të dhëna të caktuara nga raporte publike, dokumente ose analiza, të trajtuara në mënyrë sistematike dhe të komponuara nga ana e gazetarit) dhe **procesit investigativ,** në të cilin zbulohen dokumentet konfidenciale, raportet financiare, përcaktohet abuzimi i pozitës dhe i fuqisë, të cilat madje duhet të iniciojnë edhe përgjegjësi të atyre që janë përfshirë në storjen investiguese.

Pastaj, në kuadër të investigimit duhet të zbulohen të dhëna të cilat **dikush tenton t'i fsheh** ndërsa të njëjtat janë me **interes publik,** ndërkaq publiku ka të drejtë të dijë për to: shpenzimi i parave të buxhetit, abuzimi i mjeteve dhe financave në vetëqeverisjen lokale, korrupsioni, abuzimi i fuqisë dhe pozitës për qëllime personale ose për qëllime të tjera, rrezikimi i shëndetit të popullsisë etj.

Secila storje investiguese vë në dukje probleme komplekse sociale, zbulon sjellje të paligjshme të funksionarëve publikë, abuzimin e pozitës dhe abuzimin e pushtetit përmes shfrytëzimit të resurseve me të cilat administron dhe udhëheq.

1.6. Çka nuk është gazetari investigative?

- **Raportimi për punën e mirë** të institucioneve është pi-ar, dhe jo gazetari, aq më pak investigative.

- **Rrjedhja e informacioneve** nga institucionet tek mediat dhe gazetarët (Leak Journalism) nuk është gazetari investigative. Shkaku i rrjedhjes së informacioneve mund të jetë privat, politik ose interes lukrativ të atij që ua jep gazetarëve dhe për këtë shkak mund të jetë vetëm fillimi i gazetarisë investigative.

- **Storje ekskluzive** ose raportimi nga një burim nuk është gazetari investigative. Storja investigative doemos duhet të ketë më shumë burime – njerëzore dhe të dokumentuara, si dhe verifikim të çdo informacioni.

- **Përdorimi i informacioneve për shantazhim dhe për shtrëngim** nga ana e gazetarëve, nuk është gazetari investigative, por gazetari gjobvënëse.

- **Gazetaria paparac,** përkatësisht ndjekja dhe fotografimet e fshehta dhe raportimi për jetën e personave autoritarë, biznesmenëve, shoumenëve, këngëtarëve, aktorëve, politikanëve... nuk është gazetari investigative, meqë e cenon privatësinë e personaliteteve publike. Megjithatë, gazetaria paparac mund të jetë investigative nëse për publikimin e fotografive të shkrepura fshehtas ose për cenimin e privatësisë ekziston interes publik.

- Puna investiguese bart me vete lloje të ndryshme të rreziqeve. Rreziku kryesor është mundësia e abuzimit dhe manipulimit masiv me informacionet e publikuara.

Që në historikun e hershëm të gazetarisë investigative ka pasur një sërë abuzimesh, duke filluar nga stili populist i të shkruarit dhe përhapjes së opinioneve për atë se çdo kritikë ose akuzë e publikuar në mënyrë spektakulare është e arsyeshme dhe e pamohueshme, ndërkohë e stimuloi dukurinë e stereotipave për këtë lloj të gazetarisë. **Gazetaria e cila me abuzimin e stereotipave ekzistues dhe përmes krijimit të stereotipave të rinj e stimulon jotolerancën, ksenofobinë, shovinizmin dhe dhunën,** nuk është gazetari investigative. Gazetaria e këtillë madje nuk është as gazetari, meqë nuk i përmbush as kriteret themelore: informacionet nga burimi tek lexuesi, dëgjuesi ose shikuesi të jenë të argumentuara.

2. Historiku i gazetarisë investigative

Edhe pse zanafilla e gazetarisë investigative daton nga vitet e njëzeta të shekullit të kaluar, megjithatë, si fillim simbolik i gazetarisë investigative konsiderohet afera "Uotergejt" nga fillimi viteve 1970. Bëhet fjalë për një kontribut gazetaresk i cili e zbuloi skandalin me përgjimin e oponentëve politikë të partisë në pushtet në SHBA, në të cilin u përfshi presidenti Riçard Nikson dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë. Rastin e inicioi ekipi investigues i gazetarëve të gazetës "Washington Post" ndërkaq iu bashkëngjitën edhe media të tjera. Ata publikuan një varg të storjeve investigative lidhur me skandalin dhe tentativën që të fshihet. Presidenti i SHBA-ve u detyrua të japë dorëheqje nga funksioni në vitin 1974.

2.1. Gazetarin mund ta vrisni, por nuk mund ta vrisni storjen

Rasti i njohur "Uotergejt" do të mbahet mend si njëri nga sukseset më të rëndësishëm të ekipit të gazetarëve investigues. Gazetaria investigative pas aferës "Uotergejt" mori një drejtim tjetër i cili perceptohet si "hero" dhe së këtejmi shumë redaksi botërore në ekipet e tyre caktuan gazetarë-investigues.

Ngjarja kryesore, e cila ndodhi në gazetarinë investigative amerikane, pas aferës "Uotergejt" është vrasja e Don Boles, gazetar në gazetën "Arizona Ripablik" në vitin 1976. Bolesi u vra gjatë kohës kur investigonte korrupsionin politik dhe krimin e organizuar në Arizonë. Pas ngjarjes, gazetarë nga 27 gazeta, radio dhe TV stacione e kanë vazhduar investigimin dhe në fund publikuan 23 storje për korrupsion dhe krim. Atëherë, për herë të parë, u përdor parulla: " Gazetarin mund ta vrisni, por nuk mund ta vrisni storjen".

Sipas shembullit të IRE në SHBA, që u krijua në vitin 1976, edhe në shumë vende të tjera u themeluan organizata të gazetarëve investigues, anëtarët e të cilave shkëmbejnë informacione dhe punojnë si ekip i storjeve investigative.

Edhe pse historiku i gazetarisë investigative fillon në gazetë, kjo nuk është privilegj vetëm i medias së shkruar. Përmes shfrytëzimit të veçorive të mediave elektronike, veçanërisht të hapësirës së portaleve (web portalet) krijohen storje të suksesshme investigative të cilat i trajtojnë gazetarët e radios dhe TV.

2.2. Gazetaria investigative në Maqedoni

Gazetaria investigative në Maqedoni zanafillën e vet e ka në fund të viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar, kur revista "Mllad Borec" filloi të publikojë fakte të panjohura deri atëherë për ngjarje dhe personalitete historike nga koha e pas Luftës së Dytë Botërore, të cilat i fshihte pushteti i atëhershëm i Republikës Socialiste të Maqedonisë.

Në Maqedoninë e pavarur gazetaria investigative betejën e vet e pati me instalimin e demokracisë dhe veçanërisht me paraqitjen e revistës javore "Fokus" (1995), e cila e investigoi procesin e privatizimit në Maqedoni dhe zbuloi një sërë abuzime, ndërsa më vonë revista javore "Denes" dhe gazetat private ditore "Dnevnik", "Makedonija denes" si dhe Televizioni A1, të cilat publikonin storje investigative lidhur me abuzimet politike dhe biznes abuzimet e pushtetit të atëhershëm, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1998.

Për fat të keq, abuzimet e pushtetit dhe fuqia e tij edhe sot e kësaj dite janë evidente, ndërkaq nevoja për një gazetari investigative dhe për gjetjen e platformave alternative për të njëjtën, sot është akoma më e madhe për shkak të kontrollit të medias mainstream - TV dhe shtypit, nga partitë në pushtet.

Megjithatë, aktualisht, përveç disa kanaleve të pavarura televizive, falë internetit, ekzistojnë më shumë portale informative-politike të cilat kultivojnë gazetari investigative, të financuara kryesisht me grante të fondeve dhe institucioneve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe SHBA-ve, si dhe të rrjeteve gazetareske -"Skup" Qendra për Gazetari Investigative, "BIRN"- Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative të cilat janë të specializuara pikërisht për storje investigative.

Sot, në Maqedoni, me gazetari investigative merren me dhjetëra gazetarë maqedonas nga shumë media maqedonase, me ç'rast Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë çmimin e vet tradicional për realizimin vjetor gazetaresk ia përkushtoi pikërisht gazetarisë investigative. Instituti Maqedonas i Medias (IMM), vite me radhë ndan çmime për gazetari investigative, kurse çmime të këtilla ndan edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Maqedoni.

3. Fazat e procesit investigativ

Gjatë trajtimit të storjes investigative nga ideja deri në realizim, gazetari duhet të kalojë shumë faza të procesit investigativ. Sipas Manualit të Gazetarisë Investigative në Ballkan[1] të **Sheila Koronel**, këto faza janë:

- Sigurimi i gjurmës për storjen
- Hetimi i mundësisë për realizimin e storjes
- Formulimi i hipotezës investigative
- Vendosja e storjes minimale dhe maksimale
- Investigimi dhe raportimi
- Organizimi dhe analiza e informacionit
- Të shkruarit e storjes
- Fakte dhe verifikime juridike
- Publikimi dhe transmetimi i storjes
- Ndjekja e storjes pas publikimit – "follow up"

Të gjitha këto faza janë trajtuar në detaje në njërin nga mekanizmat më të rëndësishëm të gazetarëve investigues – Sinopsisi-n e storjes investigative

3.1. Sinopsisi i storjes investigative

Sinopsisi është një listë e pyetjeve, të cilave është mjaft e rëndësishme t'u përgjigjet çdo gazetar para se të fillojë të punojë një investigim konkret gazetaresk, proces në të cilin askush nuk do dëshironte të shpenzojë kohë dhe para.

Sinopsisi është vepër e gazetarit investigues nga Danimarka, **Lars Meler,** i cili përbëhet prej përafërsisht shtatëdhjetë pyetjeve, të plotësuara dhe të precizuara në shkollat e trajnimit për gazetari investigative. Një pjese të pyetjeve të sinopsisit, gazetari investigues, në fillim nuk mund t'u përgjigjet, por më vonë, gjatë procesit investigativ, megjithatë është me rëndësi vazhdimisht t'i ketë parasysh dhe t'i rishikojë në mënyrë që të mos sorollatet gjatë investigimit. Në vazhdim ua prezantojmë pyetjet e ndara në disa grupe.

1 A guide for investigative journalists in the Balkans, Shelia S. Coronel

3.1.1. Cilat janë tezat e juaja kryesore?

Grupi i parë i pyetjeve ka të bëjë me tezat themelore të storjes investigative.

- Çka dëshironi të tregoni? (Çka dëshironi t'i komunikoni publikut përmes storjes tuaj investigative? Duhet të jeni i shkathët që këtë ta shpjegoni me një fjali)
- Në cilën mënyrë dëshironi ta tregoni atë? (intervistë, reportazh, analizë e dokumenteve...)
- Kush është minimumi dhe kush maksimumi i storjes tuaj investigative? (titulli dhe një shpjegim i shkurtër – është me rëndësi të ëndërroni për maksimumin, megjithatë nëse nuk e përkufizoni minimumin që dëshironi ta dëshmoni, më vonë mund të zhgënjeheni)
- Pse dëshironi ta tregoni atë? Cilat janë motivet e juaja (profesionale dhe private), përkatësisht a keni ju konflikt interesi?
- Për kë është e rëndësishme storja? (kush është publiku juaj?)

3.1.2. Cilat janë pyetjet më të rëndësishme të rastit?

- Krijoni një listë të pyetjeve më të rëndësishme.
- Çka dini dhe çka supozoni?
- Çka tjetër duhet të kuptoni: lidhur me legjislacionin, rrethanat dhe zakonet në mjedisin konkret të investigimit, me të dhënat statistikore, me parimet etike.

3.1.3. Krijoni një listë të informacioneve të cilat duhet të verifikohen dhe kontrollohen dhe mënyrën e verifikimi të tyre

3.1.4. Kush është i interesuar ta publikojë storjen investigative?

- Krijoni listë të personave të mundshëm të interesuar për suksesin e storjes tuaj
- Kush është i interesuar të mos publikohet storja (në redaksi ose jashtë saj)?
- Kush mund t'ju bëhet armik, cili rrezik ju paraprinë dhe çfarë mbrojtje keni ose çfarë mbrojtje duhet të kërkoni?
- Si do ta pranojë publiku storjen tuaj, kush është target publiku dhe a prisni reagime nga publiku?
- Kush mund të jetë bashkëpunëtori, burimi, insajderi juaj dhe si mund ta gjeni?

3.1.5. Bashkërenditja dhe analiza e informacioneve

- Informacionet klasifikoni sipas rëndësisë
- Informacionet klasifikoni si të verifikuara dhe të paverifikuara
- Konsultohuni me një person profesionist nga fusha përkatëse nëse keni probleme me të kuptuarit e një materie të caktuar specifike profesionale

3.1.6. Si ta prezantoni storjen investigative?

- Çka duhet të dinë lexuesit dhe në ç'mënyrë duhet ta kuptojnë atë?
- Në ç'mënyrë lexuesit duhet t'ia prezantoni procesin e investigimit, grumbullimin e dokumenteve, politikën redaktuese dhe interesimin për punën tuaj?
- Çka duhet të veçoni nga storja dhe ta prezantoni përmes fotografive, ta ilustroni me grafikë, ta mbështetni me anketa ose me efekte audio-vizive?
- Bëni një vlerësim nëse investigimin do ta publikoni në një apo në më shumë storje
- Nëse vendosni për serial, duhet të vendosni a do ta publikoni serialin pasi që t'i shkruani të gjitha pjesët e investigimit ose do të shkruani paralelisht me publikimin e pjesës së parë të storjes
- A mund të stimulojë rasti fushatë pozitive ose negative?
- A ekziston mundësia dikush tjetër të bëjë fushatë nga rasti juaj, t'ju shfrytëzoj ose abuzojë për qëllime të tij?
- A meriton tema të paralajmërohet me fushatë të veçantë mediatike, përmes afishimit të logos së veçantë, banerit, paralajmërimit, editorialit?

3.1.7. Sa kohë dhe sa para ju nevojiten?

- Bëni një përllogaritje sa kohë do t'ju nevojitet dhe sa para do t'ju kushtoj investigimi (sa ditë ose javë, cilat do të jenë shpenzimet për akses në dokumente, për investigimin, për përdorimin e teknikës dhe pajisjes?)
- Sa kohë do t'ju nevojitet për hetimin personal, a do të shfrytëzoni ndihmë nga bashkëpunëtorët, nga fotografi, ekipi i TV, nga anëtarë të tjerë të ekipit, avokatë, konsulentë?
- A ju nevojitet ndihmë nga persona profesionistë?

3.1.8. Kush është strategjia e juaj investigative?

- Krijoni orarin e hapave tuaj (kronologjikisht dhe sipas rëndësisë së procedurave). Çka do të investigoni fillimisht, çka në vazhdim dhe çka në fund?
- Krijoni agjendën kohore të aktiviteteve
- Ndani kohë për të gjitha aktivitetet e planifikuara
- Asnjëherë mos thoni: nuk kam kohë ose shpejtoj. Çdo investigim trajtohet rrënjësisht, ndërsa për një gjë të këtillë duhet të gjeni kohë

3.2. Organizoni burimet tuaja!

- Krijoni një listë të burimeve "verbale"
- Klasifikoni burimet në kryesore dhe dytësore
- Klasifikoni burimet, në mënyrë që të shihni kush çfarë përvoje ka, kush me kë është i lidhur, kush me kë është në lidhje familjare, miqësore, kush posedon biznes ose ka interesa politikë, që të jeni të sigurt kush dhe çfarë qëndrimi ka në investigimin tuaj
- Bëni dallim midis dijeve profesionale dhe qëndrimit, përkatësisht përmes komentit, burimeve neutrale dhe arbitrare
- Vendosni se kur dhe në ç'mënyrë do t'i kontaktoni burimet potenciale
- Mos u jepni shumë kohë për përgatitje, meqë ekziston rreziku t'ju fshehin dokumente dhe informacione të rëndësishme
- Insistoni tek burimet që menjëherë tua sigurojnë dokumentet për të cilat pohojnë se eksitojnë dhe se janë në favor të tyre
- Reflektoni për problemet etike dhe ligjore gjatë përdorimit të burimeve anonime, ose për burime të cilat përdorin ose u nevojitet mbrojtje e sigurt
- Krijoni listë të dokumenteve të shkruara të cilat i përdorni si burim
- Klasifikoni dokumentet sipas aksesit – publike, lehtësisht dhe vështirë të aksesshëm, dokumente të klasifikuara si konfidenciale
- Përcaktoni cilat dokumente mund t'i gjeni në internet, ndërsa për cilat dokumente ju duhet kërkim i veçantë, a janë falas dhe a janë të aksesshme pasi të paguani një shume të caktuar parash

- A ekzistojnë probleme ligjore ose etike gjatë shfrytëzimit të dokumenteve të caktuara?
- Si do t'i siguroni dokumentet e kërkuara, fotografitë, audio apo video skedarët?

3.2.1. Çka tjetër duhet të analizoni dhe kontrolloni gjatë investigimit?

- Informacionet të cilat nga supozime janë bërë fakte
- A krijojnë pasqyrë të plotë informacionet e veçanta për atë që e keni investiguar?
- A ju mungojnë informacione të caktuara të cilat duhet të plotësojnë një boshllëk evident?
- Disa informacione a kërkojnë përgjigje të pyetjeve të reja?
- Përgatitni pyetje për biseda, intervista kryesore, parashtroni pyetje të planifikuara, insistoni në përgjigje të sakta, kërkoni dokumente
- Bisedat incizoni çdoherë kur një gjë e këtillë është e mundshme
- Storjen publikojeni vetëm atëherë, kur do të jeni plotësisht të bindur se i keni përgjigjet për të gjitha pyetjet kontestuese.

3.2.2. Çka pas publikimit të storjes investigative?

- Çfarë reagime pritni?
- A jeni të përgatitur për lëvdata ose për kritika?
- A jeni të përgatitur të vazhdoni me investigimin në temën e njëjtë ose në ndonjë temë tjetër?
- A ia vlen të kaloni në gjithë këtë proces të investigimit?
- Çka është e radhës që duhet ta bëni?

Nëse ky spektër i pyetjeve ju duket tepër i gjatë, i panevojshëm ose naiv, para se të futeni në aventurën "gazetari investigative" duhet ta keni parasysh këshillën e dhënë në fillim të këtij Manuali se gazetaria investigative nuk është aspak punë e lehtë. Ajo është përplot me kurthe në çdo hap, befasitë ju ndjekin në çdo dokument të zbuluar të ri, në çdo investigim në internet, në çdo bisedë ose në çdo informacion që e keni marr nga bashkëbiseduesi.

Megjithatë, në fund, zbulimi juaj mund të ndryshojë shumë punë në mjedisin lokal për të cilin keni shkruar, madje edhe shumë më gjerë. Së këtejmi, zgjedhja se a do të merreni me "gazetari ditore" ose me "gazetari investigative" është e Juaja.

4. Këshilla të dobishme për gazetarët investigues

Çdo gazetar që do të "lundrojë" në ujërat e gazetarisë investigative, duhet t'i ketë parasysh rekomandimet si vijojnë, të cilat mund t'i ndihmojnë shumë në procesin e investigimit:

- Mos druani të futeni në të gjitha fushat e investigimit, meqë, punët asnjëherë nuk janë vetëm zi-bardhë.
- Regjistroni të gjitha çështjet ndërsa shënimet mos i hidhni. Çdoherë duhet t'u riktheheni atyre dhe të kontrolloni nëse i keni investiguar të gjitha aspektet.
- Që në fillim të investigimit duhet të siguroni fotografi, ilustrime grafike dhe elemente të tjera që do t'i përdorni për vizualizimin e storjes (çdoherë duhet të mendoni për ilustrimin paralelisht me përmbajtjen e storjes investigative)
- Storjen duhet ta shkruani në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme, megjithatë çdoherë t'u përmbaheni informacioneve kryesore të cilat duhet t'i transmetoni në mënyrë të drejtë, të saktë, profesionale dhe specialiste, pa e minimizuar (ritreguar) idenë bazike, por përmes citimit ose postimit të dokumentit të bashkëngjitur në storje.
- Nëse përdorni të dhëna nga ndonjë investigim tanimë të publikuar, duhet t'i citoni dhe të tregoni kur është realizuar investigimi, në mënyrë që lexuesit të bëjnë një distinksion se çka është ajo që e ka zbuluar autori dhe çka janë burime të përdorura.
- Investigimet gazetareske nuk shkruhen nxitimthi, dhe as shkurtimisht. Çdoherë shkruani në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe në detaje, por në mënyrë të kuptueshme.
- Storjen shkruajeni paralelisht me investigimin, ndiqeni idenë bazike të investigimit, fokusin e temës dhe mos u zgjeroni me aspekte të reja pas çdo prove të zbuluar të re. Përpiquni që informacionet e reja t'i vendosni në kornizën e sinopsisit (strukturës) të përcaktuar të investigimit në të cilin tanimë keni punuar.
- Çdoherë duhet t'i përmbaheni informacionit kryesor për shkak të të cilit e keni filluar investigimin dhe mbindërtoni sipas dokumenteve të zbuluara.
- Të shkruarit e qartë dhe të thjeshtë nuk do të thotë se duhet të shkruani përciptazi dhe në mënyrë të papërgjegjshme.
- Nëse çdo gjë nuk mund të rrëfeni në një storje investigative, atëherë duhet të shkruani dy ose më shumë. Çdo storje duhet të ketë një fokus të ri dhe të qartë.
- Në storjen investigative, të cilën e publikoni në vazhdime, nuk duhet të fusni çdo gjë që dini. Duhet të jeni të kujdesshëm gjatë plasimit të informacioneve dhe çdoherë duhet të keni një informacion në rolin e "xhol"-it tuaj nëse ka tentativa që informacioni juaj investigativ të demantohet, por pa argumente të fuqishme.

- Shumica e gazetarëve investigues i përkushtojnë një kohë të gjatë, ndërsa pastaj për një kohë të shkurtër e shkruajnë storjen. Kjo qasje është krejtësisht e gabuar. Të shkruarit, si edhe investigimit duhet t'i përkushtoni kohë të mjaftueshme.

- Tekstin e shkruar duhet ta lexoni disa herë. Kontrolloni nëse faktet e rëndësishme dhe dokumentet e cituara janë transmetuar në mënyrë të drejtë.

- Gjatë rileximit dhe redaktimit të tekstit, shpesh ndodhë të ndryshoni pjesë të caktuara të storjes, por keni kujdes, nuk guxoni ta humbisni fokusin e temës. Kontrolloni nëse dokumentet e cituara kanë të bëjnë me versionin final të storjes dhe a janë shënuar në mënyrë të saktë.

- Para se ta publikoni storjen, detyrimisht lexojeni edhe një herë. Shpeshherë pa dashje bëhen gabime në procesin e lekturimit, redaktimit dhe përgatitjes teknike të tekstit.

- Nuk guxoni të lejoni që disa detaje të caktuara teknike ta zhbëj storjen investigative të cilën e keni punuar një kohë të gjatë.

5. Testi i interesit publik në gazetari

Kur vendosin të shkruajnë për një temë të caktuar, gazetarët e kanë për detyrë të përcaktojnë se a ekziston interesi publik për të njëjtën. Kjo ka rëndësi të veçantë gjatë shkrimit të temave investigative. Interesi publik nënkuptohet kur bëhet fjalë për gazetari investigative, meqë detyra e saj është të zbulojë shkelje të ligjeve, normave morale ose abuzimin e fuqisë nga individë të caktuar dhe institucione.

Megjithatë, gazetaria është veprimtari profesionale, ndërsa gazetarët e kanë për detyrë t'u përmbahen rregullave etike dhe standardeve profesionale. Për shembull, gazetarët e kanë për detyrë ta theksojnë burimin e informacioneve të cilat i publikojnë, ta kontrollojnë informacionin nga më shumë burime, megjithatë kanë edhe obligim moral ta mbrojnë identitetin e fëmijëve dhe të miturve, të viktimave nga dhuna seksuale, si dhe privatësinë e qytetarëve.

Barometër për zbatimin ose shkeljen e standardeve etike është interesi publik, me ç'rast gazetarët e kanë për detyrë në çdo situatë ta zbatojnë të ashtuquajturin test të interesit publik.

Gazetarët, në emër të interesit publik, mund t'i anashkalojnë standardet profesionale dhe normat etike, në situatat si vijojnë:

- **Cenimi i të drejtës së privatësisë së personaliteteve publike me qëllim që të dëshmohet korrupsioni, krimi ose ndonjë shkelje tjetër e ligjeve ose normave morale (me incizim të fshehtë, me hyrje në pronën private dhe ngjashëm)**

- **Fshehja e identitetit të gazetarit ose prezantimi i gabuar para bashkëbiseduesve për shkak të zbulimit të korrupsionit, krimit të organizuar ose shkeljeve tjera të ligjeve;**

- **Përdorimi i burimeve anonime me qëllim të zbulimit të veprave të rënda penale dhe mbrojtjes së identitetit të burimeve në mënyrë që të evitohet rreziku ndaj jetës dhe mirëqenies së tyre;**

- **Shkelja e dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të bartësve të funksioneve publike. Për shembull, publikimi i të dhënave nga dosjet shëndetësore, nëse një gjë e këtillë është e domosdoshme, në mënyrë që të zbulohet paaftësia shëndetësore e ndonjë personi për ushtrimin e funksionit;**

- **Cenimi i rregullit për ruajtjen e fshehtësisë bankare nëse me publikimin e të dhënave zbulohet prona e fituar në mënyrë të paligjshme;**

- **Shkelja e dispozitave ligjore për ruajtjen e fshehtësisë afariste, shtetërore ose ushtarake, nëse bëhet fjalë për zbulim të mega-skandaleve korruptive dhe financiare, marrëveshjeve të dëmshme ndërshtetërore ose shtetërore - komerciale;**

- **Shmangie nga rregulli për mbrojtjen e identitetit të fëmijëve dhe të miturve në mënyrë që të alarmohet rrezikimi i jetës dhe mirëqenies së tyre (abuzimi i punës së fëmijëve, keqpërdorimi i fëmijëve për kryerjen e veprave penale dhe ngjashëm)**

Me rastet e theksuara më lartë nuk shteret lista e dyshimeve etike me të cilat ballafaqohen gazetarët, megjithatë është e rëndësishme që çdoherë të zbatohet testi i interesit publik.

SHËNIM I VEÇANTË: Gjatë investigimit dhe procesit investigativ, çdo gazetar do të ballafaqohet me dhjetëra situata të cilat nuk mund t'i parashikojë teoria. Shkathtësia e çdo gazetari duhet të vijë në shprehje në situatë kur duhet t'i përdor rregullat "e tij" (gjithsesi, në kuadër të normave etike) në mënyrë që të vijë deri te informatat të cilat nuk mund t'i siguroj në mënyrat e lartpërmendura. Çdo gjë që nuk është e ndaluar është e lejuar, ndërsa nga shkathtësia e gazetarit do të varet edhe suksesi i tij. Secili do të tentojë të fsheh çdo gjë, e juaja është se si dhe në ç'mënyrë do ta zbuloni këtë.

6. Studimi i rastit

Sh. F. ishte gjyqtar në një gjykatë në Maqedoninë Perëndimore. Në kohën kur u avancua për gjyqtar të Gjykatës së Apelit në rajonin e tij, një gazetar zbuloi se gjyqtari ka gjykuar një lëndë në të cilën, njëra nga palët ka qenë nëna e tij. Bëhet fjalë për procedurë civile, ndërsa gjyqtari, sipas ligjit, në asnjë rast nuk guxon të veproj ndaj lëndëve kur paditësi ose i padituri janë persona të afërt me të. Gazetari kishte informata se ekziston një aktgjykim i këtillë, por e kishte vështirë si të arrijë deri te dokumenti, kur asnjërës nga palët e kontestit nuk i konvenonte ta ndajë këtë fakt me publikun, meqë bëhej fjalë për procedurë të fshehtë të cilën e kanë zbatuar pa e kuptuar askush.

I përballur me sfidën, për të krijuar storje cilësore, gazetari e gjen mënyrën që t'i verifikojë të dhënat elementare: numrin e lëndës – aktgjykimin, kush ka paditur, kush ka qenë gjyqtari, ndërsa pastaj e gjen mënyrën të verifikojë nëse palët dhe gjyqtari janë në lidhje gjaku.

Gjykata, e cila duhet të jetë burim i informacioneve të rastit, refuzon ta jap në këqyrje aktgjykimin apo kopjen e aktgjykimit, meqë për një gjë të këtillë nuk ka pajtim nga palët.

Në këtë rast, gazetari i vë në funksion të gjitha relacionet e tij në gjykatë dhe në mënyrë "joformale" arrin të sigurojë kopje nga aktgjykimi. Tanimë kur është i sigurt se posedon provë materiale, në një solemnitet publik, duke incizuar me kamerë i drejtohet gjyqtarit Sh. F. dhe e pyet se a është e saktë se ka gjykuar lëndë në të cilën nëna e tij është palë, situatë e cila është në kundërshtim me ligjin.

Gjyqtari, para kamerës, pohoi se nuk është e saktë dhe se një gjë e këtillë nuk ekziston! Gazetari i parashtron pyetje plotësuese: A e keni të njohur lëndën me numër XX/07 të cilën e keni gjykuar ju në dobi të nënës tuaj! Gjyqtari nuk përgjigjet, por kamera e regjistroi shprehjen e fytyrës së tij.

Gazetari e publikon storjen në të cilën e ka mohimin e gjyqtarit, por edhe kopjen e aktgjykimit me të gjitha të dhënat e rëndësishme.

Pas transmetimit të kontributit televiziv, Këshilli Gjyqësor, sipas detyrës zyrtare, ngre procedurë kundër gjyqtarit, konstaton se ka gjykuar një lëndë të këtillë dhe e shkarkon gjyqtarin nga funksioni.

Një vit më vonë gjyqtari i shkarkuar kërkon të takohet me gazetarin. Gazetari e pranon sfidën. Në atë takim gjyqtari pranoi se ka gabuar dhe se ka pasur dëshirë të njoftohet me gazetarin i cili pati sukses ta zbuloj fshehtësinë e tij. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë këtë storje e nominoi me Çmimin vjetor të gazetarisë investigative për vitin 2007.

Pyetje etike të cilat i hap ky shembull:

- A duhet ta publikojë gazetari storjen edhe në situatë kur subjekti të cilit i dedikohen pyetjet mohon se ka marrë një vendim të atillë?
- A duhet t'u besojë gazetari burimeve të shkruara ose verbale dhe si të jetë i sigurt për atë se çka është e vërtetë?
- Rreziku nga shpifja dhe ofendimi nuk guxon të jetë shkak për vet-censurë .

KAPITULLI 2:
QASJA E LIRË NË INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK

Me Ligjin për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë në informacionet me karakter publik[2], i cili zbatohet nga 1 shtatori i vitit 2006 rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura e realizimit të së drejtës së qasjes së lirë në informacionet me karakter publik të cilat i posedojnë organet e pushtetit shtetëror dhe entet e institucionet e tjera të përcaktuara me ligj, si dhe personat juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë autorizime publike dhe veprimtari me interes publik.

Ky Ligj e imponon transparencën dhe publicitetin në punën e poseduesve të informacioneve dhe u mundëson personave fizikë dhe juridikë ta realizojnë të drejtën e qasjes së lirë në informacionet me karakter publik.

2.1. Pse është i rëndësishëm zbatimi i Ligjit për qasje të lirë në gazetarinë investigative?

Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik në shikim të parë duket voluminoz, konfuz, me procedura të rrepta ligjore të cilat shpeshherë i "ndërpresin" gazetarët që në start të investigimit të tyre kështu që ata nuk parashtrojnë kërkesë për qasje në informacione ose nuk e vazhdojnë procedurën ankimore nëse janë refuzuar.

Megjithatë, ky është gabimi më i madh që e bëjnë gazetarët të cilët, duke hequr dorë nga sorollatjet nëpër labirintet juridike, rrezikojnë të mos krijojnë storje të mirë investigative, meqë Komisioni ose gjykatat administrative nuk kanë çdoherë qëndrim të njëjtë me poseduesin e informacionit, kështu që në procedurë ankimore mund t'i urdhërojnë t'ia japin informacionin kërkuesit. Marrë në përgjithësi, Ligji nuk i ndihmon gazetarët të cilët shkruajnë tema me agjendë ditore, meqë i njëjti ka të bëjë me procedura dhe afate, por është i mirëseardhur për investigime të mëdha dhe serioze të cilat zgjasin me muaj dhe të cilat bazohen pikërisht në investigimin dhe krahasimin e të dhënave të institucioneve të ndryshme.

Në këtë rast, përmes kryqëzimit të të dhënave, si dhe përmes shqyrtimit të raporteve të ndryshme financiare gazetarët mund të bëjnë storje të jashtëzakonshme investigative. Prandaj, sado që të duket e mundimshme rruga ligjore për sigurimin e informacioneve, ajo është shumë e rëndësishme në investigimet madje do të ishte mirë që gazetarët t'i shfrytëzojnë të gjitha format ligjore të cilat mund t'i shpijnë deri te informacioni i kërkuar.

Gjatë kërkimit të të dhënave nga Regjistri Qendror i Maqedonisë si dhe nga gjykatat, do të ballafaqoheni me një praktikë dhe zgjidhje të cilat nuk janë rregulluar me Ligjin për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, kështu që në të gjitha të dhënat e Regjistrit do të keni akses vetëm nëse paguani një shumë të caktuar sipas tarifës së Regjistrit Qendror ose sipas Ligjit për taksë gjyqësore.

2 Ligji për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë në informacionet me karaktere publik, "Gazeta Zyrtare e RM" nr.13/06

Megjithatë, nëse kërkoni një informacion të caktuar në gjykatë, për shembull, aktgjykim të plotfuqishëm ose aktgjykim të anonimizuar nëse është i shkallës së parë, të njëjtin mund ta merrni falas nëse theksoni se e kërkoni në formë elektronike (në e-mail ose ce-de).

Gazetaria investigative, e bazuar në të dhëna dhe dokumente, vlerësohet jashtëzakonisht dhe, së këtejmi, çdoherë kur ka mundësi për një gjë të këtillë, kërkoni transkripte ose kopje nga dokumentet, informacionet e nevojshme dhe gjatë investigimit disa herë kthejuni të njëjtave, gjithnjë derisa të jeni të sigurt se i keni lexuar në mënyrë të drejtë ose se i keni shfrytëzuar të gjitha të dhënat që i përmbajnë dokumentet të cilat janë me interes për storjen tuaj investigative.

Nëse nuk ekziston ndonjë opsion tjetër, bëni këqyrje në dokumente të caktuara, përpiquni t'i shënoni në mënyrë të drejtë të dhënat kryesore, numrin arkivor dhe datën, dhe këtë nënvizojeni në investigimin, në mënyrë që ta bindni publikun se investigimi juaj mbështetet në të dhëna dhe dokumente. Në bazë të të dhënave dhe dokumenteve të grumbulluara sipas Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik, krijoni dosarë-folderë tuaj me të dhëna, ndërsa informacionet e sapo grumbulluara krahasoni me të dhënat që i posedoni, meqë në këtë mënyrë, çdoherë dhe në çdo kohë mund të zbuloni informacion të ri i cili mund t'ju shpijë në një investigim të ri.

Veçanërisht duhet t'i keni parasysh emërtimet e firmave, themeluesit dhe drejtorët e tyre, ndërlidhjen kapitale të subjekteve dhe biznes relacionet e tyre në vende të ndryshme. Investigimet rajonale dhe ndërkombëtare janë ëndërr për çdo gazetar, së këtejmi duke punuar në storje investigative në nivel lokal, duhet të jeni të sigurt se është e mundur që së shpejti të zbuloni ndonjë gjurmë e cila do ta zgjerojë investigimin tuaj edhe jashtë vendit dhe në këtë mënyrë do të bashkëpunoni me kolegë investigues nga rajoni, do të futeni në rrjetet e gazetarëve investigues dhe do të shfrytëzoni para nga fondet e dedikuara për investigime, si mënyrë dhe formë për stimulimin e këtij lloji të gazetarisë, i cili padyshim është ardhmëria e gazetarisë botërore.

2.2. *Kush janë poseduesit e informacioneve?*

Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik i përdor nocionet si vijojnë:

- **Posedues të informacioneve** janë të gjitha organet dhe organizatat të cilat shfrytëzojnë mjete publike, përkatësisht buxhetore, duke i përfshirë organizatat joqeveritare në pjesën e financimit dhe shpenzimit të mjeteve për projekte të cilat financohen dhe mbështeten nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

- **Informacion me karakter publik** është informacioni në çdo lloj forme të cilin e ka krijuar dhe të cilin e ka në dispozicion poseduesi. Kjo nënkupton se Ligji parashikon qasje në informacione ekzistuese dhe nuk e imponon obligimin që poseduesit të krijojnë informacione të reja

  Ky është shembull i shpeshtë i refuzimit të kërkesave për qasje të lirë, meqë poseduesi i referohet rrethanës se nuk e posedon informacionin e kërkuar.

- **Kërkues i informacionit** është secili person juridik dhe fizik pa diskriminim mbi çfarëdo qoftë baze

- **Dokument** është çdo shënim i informacionit pa marrë parasysh formën fizike ose karakteristikat, tekst i shkruar ose i shtypur, harta, skema, fotografi, piktura, vizatime, skica, materiale pune, si dhe incizime tonike, me zë, magnetike ose elektronike, optike ose video-incizime në çdo formë, si dhe pajisje portative për përpunimin automatik të të dhënave me memorie të instaluara ose të transmetueshme për magazinimin e të dhënave në formë digjitale.

- **Person zyrtar** është personi i punësuar tek poseduesi i informacioneve, i caktuar të ndërmjetësoj me informacione të karakterit publik.

  Praktika dëshmon se shumë institucione nuk kanë caktuar person të këtillë brenda institucioneve, ose është bërë zëvendësimi i personit, ndërsa në ueb-faqe figuron e-maili dhe telefoni i personit i cili tanimë nuk është në atë pozitë, ose tanimë fare nuk punon në atë institucion. Në disa raste zëdhënësi është edhe personi zyrtar, edhe pse detyrat e punës i kanë të ndryshme. Ligji përcakton obligim që në secilin nga institucionet e lartpërmendura të ekzistoj personi zyrtar.

- **Testi i dëmit** është procedurë e detyrueshme të cilën duhet ta zbatojë poseduesi i informacionit, para se ta refuzojë qasjen konform nenit 6 të Ligjit, me të cilin i kontrollon pasojat mbi interesin që mbrohet, përkatësisht interesin publik që do të arrihej me publikimin e informacionit.

Në rastet e refuzimit, kërkuesit e informacioneve në ankesë duhet ta theksojnë elementin e testit të dëmit, nëse një gjë e këtillë nuk është theksuar në aktvendimin, apo nëse testi i dëmit përmes arsyetimit të dhënë nuk ofron argumente mjaftueshëm bindëse për justifikimin e tij. Testi i dëmit duhet të perceptohet edhe përmes aspektit të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka kompetencë të vetme t'i interpretoj apo justifikojë vendimet e veta, ndërsa gjykatat nacionale t'i zbatojnë. E drejta e informacioneve nuk është e pakontestueshme dhe u nënshtrohet kufizimeve, megjithatë ato duhet të kenë justifikime të qëndrueshme, të vlerësohet interesi publik në raport me dëmin dhe të lejohet qasje në informacione.

2.3. Kufizimet ligjore në rastin kur një informacion i caktuar nuk mund të merret

Organi i cili e posedon informacionin mund ta refuzoj kërkesën për qasje në informacione nëse informacioni është:

- **Informacion i klasifikuar** me shkallë përkatëse konfidencialiteti;
- **E dhënë personale** zbulimi i të cilës nënkupton cenim të mbrojtjes të të dhënave personale;
- **Informacion për punë arkivore** i cili është përcaktuar si konfidencial;
- Informacioni dhënia e të cilit nënkupton **cenim të konfidencialitetit dhe procedurës tatimore**;
- Informacion i fituar ose i krijuar **për hetim, procedurë penale ose për kundërvajtje, për zbatimin e procedurës administrative ose civile,** ndërkaq dhënia e të njëjtit do të kishte pasoja të dëmshme ndaj rrjedhës së procedurës;
- Informacion që ka të bëjë me **interesa komerciale dhe interesa të tjerë ekonomikë,** duke i përfshirë edhe **interesat e politikës monetare dhe fiskale,** ndërkaq dhënia e të njëjtit do të ketë pasoja të dëmshme mbi realizimin e funksionit;
- Informacion nga **dokumenti i cili është në procedurë përgatitore** dhe akoma është objekt i harmonizimit tek poseduesi i informacionit, zbulimi i të cilit do të shkaktojë keqkuptim të përmbajtjes dhe informacion i cili **i rrezikon të drejtat e pronës industriale ose intelektuale** (patentë, model, mostër, vulë plumbi për mallra dhe shërbime, etiketë për origjinën e produktit).

Ligji parashikon se informacionet e përcaktuara në një shkallë të caktuar të konfidencialitetit bëhen të aksesshme kur do të pushojnë shkaqet e paarritshmërisë së tyre. Me përjashtim, kur bëhet fjalë për informacione konfidenciale, poseduesit do të lejojnë akses deri te të njëjtat në bazë të testit të dëmit detyrimisht të zbatuar, me të cilin do të konfirmohet se me publikimin e informacionit të atillë, pasojat mbi interesin i cili mbrohet janë më të vogla nga interesi publik të përcaktuar me ligj që do të arrihej përmes publikimit të informacionit.

Obligimi për testin e dëmit është përkufizuar në mënyrë të saktë, megjithatë në Ligj nuk është përcaktuar procedura pas përfundimit të testit të dëmit. Ky mospërcaktim ligjor është regjistruar edhe në legjislacionet e vendeve të tjera dhe, së këtejmi, testi i dëmit nuk e përmbush çdoherë qëllimin e vet.

Numri i përjashtimeve, edhe në aktet normative dhe në praktikë, duhet të jetë i kufizuar dhe rreptësishtë i rezervuar meqë nuk ka përkufizim të shkruar për testin. Testi zbatohet vetëm për përjashtime të aksesit të lirë, përfshirë këtu edhe dokumentet e klasifikuara dhe të dhënat personale. Ndërkaq, çdo gjë tjetër është (duhet të jetë) e lirë dhe e aksesshme për qytetarët.

Ligji, në këtë pjesë, është mjaft liberal dhe nuk parashikon përjashtime nga realizimi i testit të dëmit dhe për këtë shkak, me kërkesë të qytetarëve dhe gazetarëve, poseduesi i informacionit duhet të bëjë test për të gjitha informacionet, përfshirë edhe dokumentet e klasifikuara me shkallën më të lartë të klasifikimit "fshehtësi shtetërore" ose të dhënat e mbrojtura personale të cilat i nënshtrohen rishikimit përmes testit të dëmit, nëse vlerësohet se interesi publik prevalon mbi interesin privat.

2.4. Si duhet të zbatohet testi i dëmit?

Testi i dëmit zbatohet në tri pjesë.

- **Informacioni duhet të jetë në raport me qëllimin legjitim të përcaktuar në ligj.** (Përjashtimi duhet të ketë bazë, përkatësisht të jetë saktësisht i përcaktuar dhe përshkruar në ligj). Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik këtë e përcakton në nenin 6, në të cilin janë përcaktuar 8 përjashtime, të theksuara më lart.

- **Përmes qasjes, a mundësohet dëmi esencial për qëllimin e mbrojtur?** Duke e zbatuar testin poseduesi duhet të sigurojë provë se zbulimi i informacionit të kërkuar do ta dëmtojë, përkatësisht interesit të mbrojtur do t'i shkaktojë cenim të konsiderueshëm (*gjithsesi se kjo është esenca e testit edhe pse praktika tregon se vështirë është çdo herë të matet dëmi*)

- **Dëmi që do t'i shkaktohet qëllimit të mbrojtur duhet të jetë më i madh se interesi publik që të zbulohet informacioni në fjalë.** (sidoqoftë, zbulimi i informacionit duhet të jetë qëllimi primar, ndërsa dëmi duhet të jetë i madh dhe evident pa sqarime plotësuese)

Ajo që është veçanërisht e rëndësishme, por që mund të jetë me rëndësi të madhe për poseduesit e informacioneve, për të punësuarit e tyre, gazetarët ose qytetarët është edhe dispozita "lirohet nga përgjegjësia i punësuari tek poseduesi i informacioneve i cili kërkuesit do t'i japë informacion të mbrojtur i cili është i rëndësishëm për zbulimin e abuzimit të pozitës zyrtare, gjegjësisht për zbulimin e korrupsionit, si dhe në rastet kur me informacionin e dhënë parandalohen kërcënime serioze ndaj shëndetit të njerëzve ose ndaj mjedisit jetësor.

Komisioni për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik ka miratuar Udhëzues në të cilin i trajton procedurat dhe autorizimet e poseduesve të informacioneve në të cilin mes tjerash e më shumë dukje, si vijon:

Nëse dokumenti i kërkuar ose një pjesë e tij përmban informacione (me shkallë konfidencialiteti) të cilat mund të ndahen nga dokumenti pa u rrezikuar siguria e tij, poseduesi i informacioneve i ndan ato informacione nga dokumenti (përmes shlyerjes së tyre ose përmes fshehjes së tyre gjatë kopjimit) dhe e njofton kërkuesin me përmbajtjen e pjesës së mbetur të dokumentit. Nëse dokumenti i kërkuar përmban të dhëna personale, të cilat janë të mbrojtura konform Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të njëjtat shlyhen.

Çdo posedues i informacioneve e ka për detyrë me akt të përcaktojë një ose më shumë persona zyrtarë për ndërmjetësim gjatë realizimit të së drejtës së qasjes së lirë në informacione. Personi zyrtar e ka për detyrë ta zbatojë procedurën sipas kërkesës për qasje në informacione me karakter publik, t'u ndihmojë kërkuesve me qëllim që në mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë, me më pak shpenzime dhe me më pak humbje të kohës, ta marrin informacionin e kërkuar, me ç'rast do ta realizojnë të drejtën e tyre të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ndërkaq të operacionalizuar me Ligj.

Poseduesi i informacionit duhet t'ia sigurojë kërkuesit formularin e kërkesës për qasje në informacione, të përcaktuar nga Komisioni si dhe t'i sigurojë hapësira për këqyrje në informacionet e kërkuara. Këqyrja në informacionet e kërkuara është falas. Listën e informacioneve, poseduesi duhet rregullisht ta përditësojë, ndërsa bazë për refuzimin e kërkesës nuk mund të jetë arsyetimi se informacioni i kërkuar nuk është në listën e informacioneve. Bazë për refuzimin e kërkesës mund të jetë vetëm neni 6 i Ligjit paraprakisht të theksuar.

Ai i cili e posedon informacionin duhet të sigurojë qasje falas deri te informacionet me karakter publik. Nëse informacioni i kërkuar është me vëllim më të madh, poseduesi mund të kërkojë që kërkuesi paraprakisht ta paguajë kompensimin për mbulimin e shpenzimeve reale që ta marrë informacionin, të cilat kanë të bëjnë me kopjimin, shtypjen ose ndonjë formë tjetër. Shpenzimet për marrjen e informacioneve janë përcaktuar me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

2.5. *Si kërkohet informacioni me karakter publik?*

Procedura për realizimin e së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik është me rëndësi të jashtëzakonshme dhe për shumicën e kërkuesve, përfshirë edhe gazetarët, ajo paraqet pengesë për shkak të së cilës kërkesat shpeshherë refuzohen për shkak të mosnjohjes dhe gabimeve të procedurës.

Kërkimi i informacioneve mund të bëhet: **verbalisht, me shkrim, në formë elektronike** ose **në formë tjetër.** Nëse kërkesa paraqitet me shkrim dhe drejtpërsëdrejti tek poseduesi i informacionit, atëherë në ekzemplarin, i cili mbetet tek kërkuesi, duhet të vendoset vula e pranimit me datën e pranimit. Nëse kërkesa paraqitet me shkrim dhe përmes postës, më së miri është që kjo të bëhet përmes dërgesës rekomande, sepse me pranimin postar ose ridërgimin dëshmohet data kur është dërguar ose pranuar kërkesa. *Kjo, veçanërisht vlen, sepse nga data e pranimit rrjedhë afati i përcaktuar me ligj për veprim sipas kërkesës.*

Ai që e kërkon informacionin mund të fitojë qasje deri te i njëjti përmes këqyrjes, të kërkojë transkript, fotokopje ose regjistrim elektronik.

2.6. Kërkesa verbale si mënyrë më e shpejtë e marrjes së informacionit

Nëse kërkuesi paraqet kërkesë verbale për qasje në ndonjë informacion të caktuar, ai që e posedon informacionin e ka për detyrë t'i sigurojë kohë të mjaftueshme për njohjen me përmbajtjen e tij, për çka personi zyrtar duhet të përpilojë shënim zyrtar. Nëse informacioni paraqet përjashtim nga qasja e lirë, e përcaktuar në nenin 6 të Ligjit, atëherë personi zyrtar duhet ta përgatis aktvendimin me të cilin do ta refuzojë qasjen në informacionin e kërkuar.

Nëse poseduesi i përgjigjet pozitivisht kërkesës verbale, atëherë e ka për detyrë menjëherë, ose më së voni në afat prej 5 ditësh, ta njoftojë kërkuesin me përmbajtjen e informacionit të kërkuar, në formën që është shënuar në kërkesë.

Nëse poseduesi e refuzon kërkesën, ose nëse nuk përgjigjet fare, apo kërkuesi paraqet kundërshtim me shkrim ose verbal për mënyrën e njoftimit, personi zyrtar për ndërmjetësimin e informacioneve e ka për detyrë të përpilojë konkluzion, kundër të cilit kërkuesi ka të dejtë ankese deri te Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës së Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik.

2.7. Kërkesë me shkrim për marrjen e informacioneve me karakter publik

Kërkesë për marrjen e informacionit me karakter publik, gazetari mund të paraqesë edhe në formë të shkruar. Forma e formularit të kërkesës është përcaktuar nga Komisioni dhe sipas rregullit gazetarët këto kërkesa duhet t'i parashtrojnë në këtë formular, megjithatë ky nuk është kushti kryesor. Formulari, i përcaktuar nga Komisioni gjendet në ueb-faqen: http://www.komspi.mk/?page_id=323

Gazetari, jo domosdoshmërish duhet ta paraqes në këtë formular kërkesën për qasje në informacionet, edhe pse me të thjeshtëzohet procedura e përpilimit të kërkesës. Kërkesën mund ta paraqes edhe në një shkresë të thjeshtë, e cila është me rëndësi t'i përmbajë të dhënat e parashikuara në nenin 16 të Ligjit për qasje të lirë në informacion me karakter publik në të cilën duhet të potencojë se informacionet i kërkon në përputhje me këtë Ligj. Ato janë: emri dhe mbiemri i kërkuesit, adresa dhe të dhëna të tjera për kontakt.

Në kërkesë nuk shënohet, ndërsa poseduesi i informacionit nuk ka të drejtë të kërkojë nga gazetari, të tregoj se përse e kërkon informacionin.

Në kërkesë, gazetari doemos duhet ta theksojë mënyrën me të cilën dëshiron të njihet me përmbajtjen e informacionit të kërkuar (këqyrje, transkriptim, fotokopje, regjistrime elektronike ose mënyrë tjetër). Nëse institucioni deri te i cili është dërguar kërkesa, nuk disponon me informacionin e kërkuar, menjëherë ose më së voni në afat prej tre ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës, e ka për detyrë t'ia ridërgojë kërkesën poseduesit të informacionit dhe për këtë do ta njoftoj kërkuesin.

2.8. Përgjigje ndaj kërkesës për marrjen e informacionit sipas qasjes së lirë

Në rastet kur poseduesi i informacionit do të përgjigjet pozitivisht ndaj kërkesës, menjëherë i mundëson gazetarit njoftim me përmbajtjen e informacionit të kërkuar edhe atë përmes këqyrjes, fotokopjimit ose regjistrimit elektronik, për çka do të përpilojë procesverbal.

Përgjigje pozitive konsiderohet edhe konkluzioni me të cilin poseduesi e ndërpret procedurën, për shkak se nuk e ka në posedim informacionin e kërkuar. Kundër konkluzionit të këtillë lejohet ankesë deri te Komisioni.

Nëse gazetari tanimë ka marrë përgjigje pozitive për qasje në një informacion të caktuar, ndërsa në afat prej gjashtë muajve paraqet kërkesë për qasje në informacionin e njëjtë dhe tek poseduesi i njëjtë, ai nuk e ka për detyrë t'i përgjigjet përsëri kërkesës, por me konkluzion do ta ndërpresë procedurën. Kundër konkluzionit të cekur, gazetari ka të drejtë të paraqesë kërkesë deri te Komisioni. Aty do të vlerësohet vetëm elementi nëse informacioni i cekur ka pësuar korrigjime ose plotësime.

Kur gazetari do ta merr informacionin, kurse nga i njëjti rezulton kërkesa për informacion plotësues lidhur me dokumentin e njëjtë, në rast të këtillë duhet të paraqesë kërkesë të re, në përputhje me nenet 15 dhe 16 të Ligjit, bashkë me përgjigjen të cilën tanimë e ka pranuar.

Kur gazetari do të njoftohet me informacionin të cilin nuk e ka cekur në kërkesën e tij, përkatësisht kur poseduesi rastësisht ose qëllimisht i ka dhënë informacion tjetër, dhe jo atë të cilin e ka cekur në kërkesë, atëherë duhet të paraqesë kërkesë të re, ndërsa institucioni e ka për detyrë sipas kërkesës së re të veproj në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit.

Nëse në afat prej 30 ditësh poseduesi nuk ka përpiluar dhe nuk ka dërguar kurrfarë akti deri te gazetari, konsiderohet se kërkuesi ka pranuar aktvendim për refuzimin e kërkesës. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për gazetarët sepse pas skadimit të afatit të përcaktuar ligjor, mund të paraqesin ankesë deri te Komisioni.

Sipas rregullit, poseduesi informacionin ia dërgon kërkuesit në formën siç është cekur në kërkesë, dhe siç parashikohet me ligj. Nga rregulli i cekur parashikohet përjashtim edhe atë, nëse informacioni i kërkuar tanimë ekziston në formën e përshkruar paraprakisht dhe është i aksesshëm për publikun ndonëse është më e volitshme për kërkuesin që informacioni të dërgohet në një formë tjetër nga ajo që është kërkuar. Për shembull: nëse kërkuesi ka postë elektronike, ndërkohë që kërkon fotokopje nga një informacion, ndërsa poseduesi e ka në formë elektronike, atëherë me qëllim të shmangies së shpenzimeve për fotokopjim dhe dërgesës me postë, informacioni i kërkuar mund të dërgohet përmes postës elektronike.

Afati i përgjigjes së kërkesës për qasje në informacion mund të vazhdohet më së shumti deri në 40 ditë vetëm në rastin kur dokumenti që kërkohet është voluminoz, ose nëse poseduesi duhet t'i mundësojë gazetarit qasje të pjesshme deri te informacioni i kërkuar, përmes shlyerjes së të dhënave me shkallë konfidencialiteti, siç është përshkruar më lartë.

Për vazhdimin e afatit, poseduesi e ka për detyrë ta njoftojë gazetarin dhe në njoftim t'i arsyetojë shkaqet për të njëjtin. Njoftimin e cekur duhet ta dërgojë më së voni deri në ditën e 27 nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse njoftimi nuk dërgohet atëherë konsiderohet se bëhet fjalë për "heshtje" dhe gazetari mund të paraqesë ankesë deri te Komisioni.

Në këtë rast, afati i paraqitjes së ankesës nuk kufizohet, përkatësisht kërkuesi mund të paraqesë ankesë deri te Komisioni gjithnjë derisa ka nevojë për informacionin e kërkuar dhe derisa mendon se i është cenuar e drejta e qasjes.

2.9. Procedura ankimimi (gjyqësore)

Të drejtën e mbrojtjes juridike, ose të drejtën e paraqitjes së ankesës deri te Komisioni, e ka vetëm gazetari i cili ka paraqitur kërkesë me shkrim për qasje në informacione me karakter publik. Gazetari ka të drejtë të paraqesë ankesë deri te Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik, në rastet si vijojnë:

- **Kundër aktvendimit me të cilin poseduesi i informacionit plotësisht ose pjesërisht e ka refuzuar kërkesën;**

- **Nëse poseduesi i informacionit, në afat prej 30 ditësh përkatësisht 40 ditësh në rastet kur i është vazhduar afati**, ose në afat prej 10 ditësh në rastin e përsëritjes së kërkesës, nuk i ka mundësuar kërkuesit qasje në informacion dhe nëse nuk ka miratuar dhe kërkuesit nuk i ka dërguar aktvendim për refuzim të plotë ose të pjesshëm të qasjes (heshtja e administratës). Në këtë rast afati për paraqitjen e ankesës është i pakufizuar;

- **Kundër konkluzionit për ndërprerjen e procedurës** (me të cilin poseduesi do të konstatojë se kërkesa është revokuar)

- **Kundër konkluzionit të poseduesit për ndërprerjen e procedurës** (kur poseduesi do të konstatojë se nuk e posedon informacionin e kërkuar);

- **Kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës.**

Në të gjitha rastet, kur poseduesi ka miratuar akt, afati për paraqitjen e ankesës është 15 ditë nga dita e pranimit të aktit. Procedura ankimore para Komisionit zbatohet konform dispozitave të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative[3].

Më shumë informacione për mënyrën e paraqitjes së ankesës mund të gjeni në faqen e Gjykatës Administrative - Shkup: http://www.usskopje.mk/

ose në faqen e Gjykatës së Lartë Administrative: http://www.vusskopje.mk/

3 Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 124/2015

Bibliografi

1. Storia investigative Votergejt mund të e gjeni këtu : www.washingtonpost.com/wp-srv/politics/special/watergate

2. veb faqja zyrtare të Gazetarve hetuese dhe Redaktorë (Investigative Reporters and Editors) mund të e gjeni këtu www.ire.org:

3. Veb faqja zyrtare të organizatës holando-flamenze për gazetar hetues këtu www.vvoj.nl

4. Veb faqja zyrtare i regjistrit Qendror mund të e gjeni ketu www.crm.com.mk

5. Ligji mbi Qasjen e Lirë deri të informatat me karakter Publike "Gazeta Zyrtare" nr.13/06, 86/08, 6/10, 42/14, 148/15 dhe 55/16.

6. Ligji për taksa gjysore, Gazeta zyrtare nr. 114/09 dhe 148/11

7. Ligji mbi procedurën administrative, Gayeta Zyrtare nr.124/2015

8. Sheila Kornel, 2009, Grimim më thell - manual për gazetari hetues në Ballkani, BIRN, Sarajevo, Bosnja dhe Hercegovina